



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe nenit 13 dhe 14 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës 15Nr. 011-23133 e datës 06.05.2015, duke vendosur sipas kërkesës së Shoqatës së Pedagogëve të Sportit Shkollor – Lipjan, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 800 € (tetëqind euro), Shoqatës së Pedagogëve të Sportit Shkollor – Lipjan, sipas kërkesës së datës 26.01.2016.

Shuma e cekur në paragrafin paraprak i ndahet për ta mbështetur financiarisht për zhvillimin e garave shkollore për shkollat e mesme të ulëta dhe shkollat e mesme të larta për vitin 2016.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të shoqatës nr. 13-00-0010022289.20 në Banka për Biznes.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara deri në shumën e lejuar, Shoqatës së Pedagogëve të Sportit Shkollor – Lipjan duhet të sjellë raportin financiar duke i bashkëngjitur faturat. Raporti dorëzohet në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport dhe i cili duhet të jetë në përputhje me nevojat e paraqitura në Kërkesë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohet Shoqata e Pedagogëve të Sportit Shkollor – Lipjan.

1Nr. 400-3834

Lipjan, më 19.02.2016

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti

